



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.99

2005

29 dhjetor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9448 datë 5.12.2005	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” 3159
Vendim i KM nr.792, datë 16.12.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore, ndryshuar me vendimet përkatëse”, të ndryshuar” 3161
Vendim i KM nr.794, datë 19.12.2005	Për krijimin e Task Forcës Antikorrupsion..... 3162
Vendim i KM nr.801, datë 20.12.2005	Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës..... 3164
Vendim i KM nr. 802, datë 19.12.2005	Për përbërjen, funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe organizimin e brendshëm të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit. 3164
Vendim i KM nr.804, datë 16.12.2005	Për përzgjedhjen e shoqërisë për kontrollin e procedurave dhe ligjshmërinë e kontratës për privatizimin e Albtelecom sh.a.... 3177
Udhëzim i MMPAU nr.1, datë 30.11.2005	Për tarifat e shërbimit për lejet mjedisore..... 3180

L I G J
Nr. 9448, datë 5.12.2005

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8811, DATË 17.5.2001 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 4 pika 2, pas fjalës “juristë” shtohen fjalët “jo gjyqtarë”.

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5
Papajtueshmëritë

Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është i papajtueshëm me çdo veprimtari tjetër politike, publike ose private, përveç mësimdhënies.”.

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6
Kohëzgjatja në detyrë, imuniteti dhe paga

1. Anëtarët e zgjedhur qëndrojnë në detyrë për një periudhë 5-vjeçare pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme. Anëtarët e KLD-së, të zgjedhur prej Konferencës Gjyqësore Kombëtare ose Kuvendit, e ushtrojnë detyrën e tyre me kohë të plotë. Afati i qëndrimit në detyrë i anëtarëve të zgjedhur të KLD-së fillon nga data e zgjedhjes së tyre.

2. Pas përfundimit të mandatit, anëtari i zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare rikthehet pranë gjykatës ku kryente detyrën si gjyqtar, ose me pëlqimin e tij në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel. Përfundim nga ky rregull bën anëtari i KLD-së, që në detyrën e mëparshme gëzonte mandatin e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Ky anëtar përfiton të njëjtin trajtim si çdo anëtar i Gjykatës së Lartë, të cilit i përfundon afati kohor i qëndrimit në detyrë.

3. Pas përfundimit të mandatit, anëtari jo gjyqtar i zgjedhur nga Kuvendi rikthehet në detyrën shtetërore në pozicionin e mëparshëm, ose në pamundësi i ofrohet një pozicion tjetër i të njëjtit nivel ose i një niveli më të lartë, në përputhje me dispozitat ligjore të shërbimit civil, duke përjashtuar konkurrimin.

4. Anëtarët e KLD-së gjatë qëndrimit në këtë detyrë gëzojnë imunitet. Gjatë ushtrimit të mandatit ata mund të ndiqen penalisht vetëm me miratimin e KLD-së. Anëtari i KLD-së mund të ndalohet ose të arrestohet vetëm nëse kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë KLD-në. Në rast se KLD-ja nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të anëtarit të tij të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë. Në rastin kur ndaj një anëtari të KLD-së vendoset fillimi i një çështjeje penale për një krim, ai pezullohet nga funksioni derisa të merret vendimi i formës së prerë.

5. Paga e anëtarit të KLD-së është 10 për qind më e ulët se paga e Zëvendëskryetarit të KLD-së.”.

Neni 4

Në nenin 12 pikat 3 dhe 4 shfuqizohen.

Neni 5

Në nenin 13 pika 1 shfuqizohet.

Neni 6

Dispozita kalimtare

1. Brenda 15 ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që preken prej tij, duhet të paraqesin pranë Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë një deklaratë me shkrim, me anë të së cilës i konfirmojnë Këshillit zgjedhjen e ushtrimit të njërës nga detyrat.

Në rast mosparaqitjeje të deklaratës, mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbaron automatikisht në mëngjesin e ditës së nesërme.

2. Në përfundim të afatit 15-ditor, Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë informon institucionet dhe publikun për zgjedhjen, si dhe merr çdo masë të nevojshme, nëse ka vend, për të koordinuar veprimet për plotësimin e numrit të vendeve të mbetura vakant, për një mandat të plotë 5-vjeçar, sipas rastit, nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare ose Kuvendi.

3. Mandati i anëtarit të tanishëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që zgjedh njërën nga detyrat, përfundon në fund të afatit 5-vjeçar, nga data e fillimit të detyrës së tij si anëtar prej organit që e ka zgjedhur.”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 792, datë 16.12.2005

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.711, DATË 27.12.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE, ADMINISTRATËS SË PRESIDENTIT DHE KUVENDIT DHE DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE, NDRYSHUAR ME VENDIMET PËRKATËSE”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 7 të bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Sekretar i Kryeministrit, i Presidentit, i Kryetarit të Kuvendit, i zëvendëskryeministrit, nënkryetar i Kuvendit	50 666;
Sekretar i ministrit, sekretar, sekretar i këshilltarit të Presidentit	40 326.”

b) Në fund të shkronjës “c” shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Shtesa për vjetërsi në punë e punonjësve të përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 7, të jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 9306 lekë”.

2. Në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në kategorinë “I-b” shtohet emërtimi “Drejtor i Departamentit të Administratës Publike”.

3. Lidhja nr.3 “Kategorizimi i pozicioneve të punës për funksionet e veçanta në Kryeministri dhe ministritë e linjës” zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Numri i punonjësve të parashikuar për Departamentin e Administratës Publike dhe fondi i pagave, shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore, duke filluar nga data 1.12.2005, të kalojnë nga Kryeministria te Ministria e Brendshme.

5. Efektet financiare për Njësinë Antitrafik, për vitin 2005, të përballohen nga buxheti i vitit 2005 miratuar për Ministrinë e Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 14.11.2005 për nëpunësit e Departamentit të Administratës Publike dhe të Njësisë Antitrafik, në Ministrinë e Brendshme, dhe nga data 30.11.2005 për nëpunësit e Kryeministrisë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.3

KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS PËR FUNKSIONET
E VEÇANTA NË KRYEMINISTRI DHE MINISTRITË E LINJËS

INSTITUCIONI	POZICIONI	KATEGORIA E PAGËS
Kryeministria	Drejtor i Njësisë së Zbatimit të Projekteve të Bankës Botërore	II-a
	Jurist në Departamentin Juridik&të Koordinimit	II-b
	Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ& të Antikorrupsionit	II-b
	Koordinator në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive&Koordinimit Strategjik me Donatorët	II-b
Ministria e Punës dhe Çeshtjeve Sociale	Drejtor i Inspektoratit Shtetëror të Punës	II-a
Ministria e Punëve të Jashtme	Përfaqësues ligjor i Zyrës së Përfaqësuesit Ligjor	II-b
	Përfaqësues i Zyrës së Minoriteteve	II-b
	Drejtor i Institutit të Diasporës	II-b
Ministria e Mjedisit	Kryeinspektor i Inspektoratit të Mjedisit	III-a
	Inspektor në Inspektoratin e Mjedisit	III-b
Ministria e Drejtësisë	Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor	III-a
Ministria e Brendshme	Drejtor i Njësisë Antitrafik	II-a
	Përgjegjës sektori në Departamentin e Administratës Publike	II-b
	Koordinator në Njësinë Antitrafik	III-a
Ministritë e linjës	Inspektor në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm apo sektorët e auditimit të brendshëm	III-b

VENDIM

Nr. 794, datë 19.12.2005

PËR KRIJIMN E TASK FORCËS ANTIKORRUPSION

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Task Forcës Antikorrupsion, i cili të kryesohet nga Kryeministri dhe të ketë në përbërje:

- | | |
|--|------------------|
| - Zëvendëskryeministrin | zëvendëskryetar; |
| - Ministrin e Financave | anëtar; |
| - Ministrin e Brendshëm | anëtar; |
| - Ministrin e Drejtësisë | anëtar; |
| - Ministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit | anëtar; |
| - Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës | anëtar; |
| - Drejtorin e Departamentit të Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit, në Kryeministri | anëtar; |

- Drejtorin e Agjencisë së Prokurimit Publik	anëtar;
- Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave	anëtar;
- Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave	anëtar;
- Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve	anëtar;
- Kryeregjistruesin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	anëtar;
- Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme	anëtar;
- Drejtorin e Përgjithshëm të KESH-it	anëtar.

2. Task Forca Antikorrupsion ka këto funksione:

- Analizon problemet e korrupsionit dhe të etikës së qeverisjes;
- Përcakton përparësitë strategjike, synimet, objektivat dhe masat konkrete për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin;
- Propozon krijimin e grupeve të punës me ekspertë, sipas përparësive, propozon detyrat e tyre për zhvillimin e veprimtarive sektoriale, si dhe monitoron punën e tyre;
- Miraton projektin e planit të veprimit antikorrupsion dhe të mirëqeverisjes dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave;
- Përcakton fushat parësore për kontrollin e brendshëm, administrativ dhe financiar dhe, sipas rastit, mund të përcaktojë detyra konkrete kontrolli;
- Siguron bashkëpunimin ndërinstituconal për luftën kundër korrupsionit dhe zbatimin e programeve të mirëqeverisjes;
- Siguron bashkëpunimin me komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile;
- Garanton transparencë në luftën kundër korrupsionit.

3. Task Forca mbledhet një herë në dy muaj ose në çdo kohë me kërkesë të kryetarit.

4. Roli dhe përgjegjësitë e çdo anëtari të Task Forcës janë:

- të shkëmbejë informacione për çështjet e korrupsionit dhe veprimtaritë antikorrupsion në institucionin e vet;
 - të drejtojë, sipas rastit, grupet e punës sektoriale dhe të raportojë në emër të tyre;
 - të bashkërendojë të gjitha veprimtaritë e fushës që mbulojnë, si dhe të drejtojë punën për hartimin e planit të veprimeve, sipas fushës së veprimtarisë;
 - të raportojë për zbatimin e detyrave të ngarkuara.
5. Ngarkohen të gjitha ministrat dhe institucionet qendrore që:
- të marrin masat në zbatim të detyrave të ngarkuara nga Task Forca;
 - të bashkëpunojnë me grupet e punës për hartimin e planit të veprimeve sipas fushës së veprimtarisë;

c) të raportojnë pranë Task Forcës dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit, në Kryeministri, për zbatimin e planit të veprimeve, sipas fushës së veprimtarisë së institucionit dhe të institucioneve të varësisë;

ç) të marrin masa për të garantuar informimin e publikut dhe për drejtimin e veprimtarive për ndërgjegjësimin dhe edukimin ligjor të qytetarëve;

d) të sigurojnë bashkëpunim përfshirës dhe transparent me përfaqësues të shoqërisë civile dhe të grupeve të interesit.

6. Vendimi nr.470, datë 6.10.1999 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe funksionimin e Komisionit Qeveritar të Luftës kundër Korrupsionit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 801, datë 20.12.2005

PËR HAPJEN E UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU” NË DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapja e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, në Durrës, në vitin akademik 2006-2007.
2. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, me seli qendrore në qytetin e Durrësit, do të përbëhet nga:
 - a) Fakulteti i Edukimit;
 - b) Fakulteti i Ekonomisë dhe i Administrimit;
 - c) Shkolla e lartë jouniversitare.
3. Fakulteti i Edukimit do të japë diplomë universitare në degët:
 - a) Cikli i ulët (tre vite akademike);
 - b) Gjuhë angleze (tre vite akademike);
 - c) Kualifikime pasuniversitare në fushën e mësuesisë dhe të menaxhimit të arsimit.
4. Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit do të japë diplomë universitare në degët:
 - a) Shkenca të administrimit (tre vite akademike);
 - b) Menaxhim turizëm (tre vite akademike).
5. Shkolla e lartë jouniversitare do të japë diplomë të nivelit jouniversitar. Përcaktimi i diplomave bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dy muaj para fillimit të vitit akademik.
6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 802, datë 19.12.2005

PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONET, DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË KËSHILLIT TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli i Zhvillimit të Turizmit, si organ ndërministror, të kryesohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
 - Zëvendësministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
 - Zëvendësministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
 - Zëvendësministrin e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
 - Zëvendësministrin e Financave;

- Zëvendësministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- Zëvendësministrin e Brendshëm;
- Zëvendësministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Drejtorin e Drejtorisë së Politikave të Turizmit pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sekretar/anëtar.

2. Funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe organizimi i brendshëm i këtij këshilli përcaktohen në rregulloren që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Anëtarët e këtij këshilli të shpërblehen për pjesëmarrje, për çdo mbledhje, në masën 10000 (dhjetë mijë) lekë, por jo më shumë se një herë në muaj.

4. Fondet për shpërblimin e anëtarëve të këtij këshilli të përballohen nga buxhetet e miratuara për çdo institucion që ata përfaqësojnë.

5. Vendimi nr.789, datë 26.11.2003 i Këshillit të Ministrave “Për funksionimin dhe organizimin e Këshillit të Zhvillimit të Turizmit” dhe rregullorja që i bashkëlidhet këtij vendimi, shfuqizohen.

6. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE **PËR FUNKSIONIMIN, DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE ORGANIZIMIN E** **BRENDSHËM TË KËSHILLIT TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT**

Në zbatim të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, ndryshuar me ligjet nr.8163, datë 7.11.1996 “Për miratimin e një shtese të dekretit nr.1609, datë 19.9.1996 “Për një ndryshim në ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, nr.8368, datë 9.7.1998 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin” dhe nr.8904, datë 6.6.2002 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin” me ndryshimet përkatëse”, dhe të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, përcaktimi i funksionimit dhe organizimit të Këshillit për Zhvillimin e Turizmit të bëhet sipas kësaj rregulloreje.

Neni 1

Këshilli i Zhvillimit të Turizmit është organ ndërministror që krijohet dhe funksionon sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, me gjithë ndryshimet përkatëse, dhe që më poshtë do të quhet “Këshilli”.

Neni 2

Këshilli shqyrton:

- kërkesat e personave, fizikë ose juridikë, për t’u njohur ose jo atyre të drejtën të jenë “persona të stimuluar”, për të kryer veprimtari turistike të stimuluar dhe për të ushtruar të drejtat e detyrat sipas ligjit në fuqi;

- lejet e ndërtimit ose autorizimet për zhvillimin e afarizmit, që do të jepen ose janë dhënë nga organet, vendore a qendrore, për veprimtari joturistike në zonat e stimuluar, verifikojnë nëse këto veprimtari përputhen me qëllimet e krijimit të zonës së stimuluar.

Kur veprimtaria joturistike në zonën e stimuluar bie në kundërshtim me qëllimin e krijimit të kësaj zone, këshilli merr vendimin përfundimtar për refuzimin ose ndalimin e veprimit të lejes a të autorizimit në fjalë, pasi rastet e evidentuara janë vlerësuar si të parregullta nga Këshilli i Ministrave.

Këshilli shqyrton kërkesat jo më vonë se dy muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

Neni 3

Këshilli mbledhet sipas njoftimit që bëhet nga kryetari. Ky njoftim duhet të bëhet të paktën një javë përpara datës së mbledhjes.

Këshilli zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij, pra jo më pak se pesë veta.

Në rastet kur pjesëmarrja nuk sigurohet si më sipër, mbledhja e këshillit bëhet jo më vonë se dy javë nga data e njoftimit të ri.

Në rastet kur mbledhja është e domosdoshme të zhvillohet ditën e caktuar dhe mungon kryetari, ministri cakton një nga anëtarët për kryesimin e mbledhjes si kryetar provizor.

Në raste të veçanta, me propozimin e Kryetarit, këshilli mund të mbledhet në mbledhje jashtë radhe.

Kur gjykohet e nevojshme, këshilli e zhvillon mbledhjen në qendrën respektive të rrethit ku bën pjesë zona objekt i diskutimit.

Këshilli vendos me shumicë votash. Në rastet kur numri i votave është ndarë në mënyrë të barabartë, vendos vota e kryetarit të Këshillit.

Çdo anëtar i këshillit ka të drejtë të shoqërohet nga specialistë të zgjedhur prej tij (por jo më shumë se tre), të cilët marrin pjesë në mbledhje pa të drejtë vote.

Neni 4

Sekretaria teknike e këshillit, quajtur më poshtë “Sekretaria teknike”, organizon mbledhjet dhe përgatit rendin e ditës e materialet e mbledhjes.

Sekretari i këshillit, që drejton sekretarinë teknike, është Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Turizmit.

Veprimtarinë e sekretarisë teknike të këshillit do ta kryejë Drejtoria e Politikave të Turizmit, pjesë përbërëse e Strukturës së Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve.

Sekretaria teknike ka këto detyra:

- Grumbullon kërkesat, që paraqiten nga persona, fizikë apo juridikë, vendas ose të huaj, për të ushtruar veprimtari të stimuluar në pronësi private, sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, me ndryshimet përkatëse, dhe ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

- Regjistron kërkesat, negocion me kërkuesit për problemet që lidhen me çështjet e kërkesave të tyre.

- Kontakton me autoritetet e tjera për zgjidhjen e problemeve për kërkesat e paraqitura.

- Harton vendimin në bazë të procesverbalit të mbledhjes së këshillit.

- Kontrollon zbatimin e vendimeve.

Sekretaria zbaton procedurat e veprimit me dosjen-kërkesë, sipas përshkrimeve në aneksin A (pjesë e kësaj rregulloreje).

Neni 5

a) Kërkesat e një personi, fizik apo juridik, për të zhvilluar ose vazhduar veprimtari të stimuluar, duhet të jetë e plotësuar sipas formularit 1 dhe aneksit B (pjesë e kësaj rregulloreje) shoqëruar me derdhjen në llogarinë e institucionit të turizmit të “shpenzimit administrativ”, të pakthyeshëm, 100 USD.

Deri në plotësimet përfundimtare, kërkesa është e paraqitur, por jo e regjistruar.

b) Kur kërkesa është e plotë, sekretaria njofton kërkuuesin për pagesën e depozitës së parashikuar në shkronjën “a” të nenit 7 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”:

- për investime të klasës A- 30 000 (tridhjetë mijë) USD;
- për investime të klasës B-150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) USD;
- për investimë të klasës C-150000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) USD.

Shuma depozitohet nga personi, fizik apo juridik, në një llogari rrjedhëse, në një bankë, shqiptare ose të huaj, të pranuar nga Banka e Shqipërisë. Kur formulari shoqërohet me pagesën e depozitës së përmendur më sipër dhe me konfirmimin bankar të saj, atëherë këshilli do të merret plotësisht me çështjen dhe data e paraqitjes së konfirmimit bankar do të jetë dhe data e paraqitjes së kërkesës, në kuptimin e dispozitave të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”.

Neni 6

Këshilli, nëpërmjet sekretarisë teknike të saj, kërkon nga organet, qendrore ose vendore, vënien në dispozicion të tij të shesheve të ndërtimit për struktura turistike, në zonat e stimuluar ose ato urbane, së bashku me studimet urbanistike, të miratuara sipas dispozitave në fuqi, kushtet urbanistike, teknike etj., si dhe çdo element tjetër të nevojshëm për një shesh ndërtimi, që do të zhvillohet nga kërkuesi.

Neni 7

Sekretaria teknike ka për detyrë:

- të kryejë të gjithë anën protokollare dhe të administrojë dosje-kërkesat e personave, fizikë e juridikë, që këshilli ka shqyrtuar ose do të shqyrtojë;
- të njoftojë anëtarët e këshillit për datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes së këshillit, të marrë konfirmimet për pjesëmarrjen dhe të vërë në dijeni kryetarin;
- të njoftojë personat, fizikë apo juridikë, rreth vendimit të këshillit për kërkesat e tyre;
- të sistemojë në dosjet përkatëse të gjitha vendimet paraprake, vërejtjet ose kundërshtimet, si dhe vendimet përfundimtare.

Neni 8

Në mbështetje të neneve 7, 8, 9 e 10 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 të këshillit, nëpërmjet sekretarisë teknike, harton dhe organizon lidhjen e marrëveshjes së zhvillimit ndërmjet personit, fizik ose juridik, të stimuluar dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Veprimtaria e stimuluar fillon në datën e përcaktuar në marrëveshjen e zhvillimit.

Marrëveshja e zhvillimit mund të hidhet pasi personi, fizik apo juridik, ka përmbushur të gjitha detyrimet që përcakton ligji dhe ka paraqitur dokumentacionin e përshkruar në aneksin C (pjesë e kësaj rregulloreje). Sipas rastit, si fillim i veprimtarisë së stimuluar do të quhet:

1. Akti i piketimit të objektit, kur veprimtaria ose pjesë e saj është:
 - ndërtimi apo zgjerimi i strukturave ndërtimore, turistike, të përcaktuara në nenin 3 të ligjit 7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”;
2. marrëveshja e zhvillimit, kur veprimtaria është:
 - rikonstrukcioni i strukturave apo përmirësimi i procesit të operimit të veprimtarive të stimuluar, të përcaktuara në nenin 3 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”
 - shërbimi i transportit turistik dhe agjencive turistike apo veprimtaritë kulturore;
 - prodhimi, magazinimi dhe shpërndarja e artikujve ushqimorë, artistikë e artizanalë, si dhe pajisjeve sportive të sporteve ujore;

3. marrëveshja e menaxhimit me operatorin turistik, kur veprimtaria është proces i operimit të strukturave, të cilësuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 9

Pas shqyrtimit nga këshilli të kërkesave për dhënien e lejes për veprimtari të stimuluar ose për vazhdimin e saj, ndiqet procedura si më poshtë vijon:

a) Këshilli bën të njohur vendimin paraprak për kërkesën dhe pala e interesuar ka të drejtë t'i paraqesë këshillit, brenda 90 ditëve, propozimet ose kundërshtimet për këtë vendim.

b) Këshilli vendos, përfundimisht, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së propozimeve ose kundërshtimeve.

c) Kur e gjen të rregullt e të bazuar në procedurat ligjore, Ministri shpall vendimin e këshillit. Në rast të kundërt ai e kthen atë për rishqyrtim në këshill.

ç) Lidhet marrëveshja e zhvillimit ndërmjet personit, fizik apo juridik, dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 10

Personi, fizik apo juridik, me marrjen e së drejtës për të zhvilluar veprimtari të stimuluar, brenda afateve të përcaktuara në shkronjën “a” të nenit 7 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”(6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës), duhet të përgatisë projektin teknik ose studimin e nevojshëm dhe atë ekonomiko-financiar.

Neni 11

Këshilli, nëpërmjet sekretarisë teknike, kontrollon dhe verifikon fillimin e veprimtarisë së stimuluar nga personi i stimuluar, brenda afatit të përcaktuar në marrëveshjen e zhvillimit.

Sekretaria teknike njofton në kohë këshillin rreth zbatimit të vendimeve të tij. Në veçanti, ajo njofton për çdo vonesë në afatin e marrëveshjes (pagesa, projekte etj.), në mënyrë që këshilli të ketë mundësi të vendosë rreth çështjes, si dhe për ndonjë pengesë që mund t'i dalë kërkuesit me autoritetet vendore për të siguruar vazhdimin sipas projektit të miratuar.

Neni 12

Të gjitha anekset që bashkëlidhen janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

ANEKSI A (PROCEDURA)

1. Të gjitha kërkesat apo dosje-kërkesat e aplikantëve protokollohen.
2. Pas shënimit që u bëhet kërkesave apo dosjeve përkatëse, për mënyrën e trajtimit të kërkesës dhe përpunimit të saj nga titullari institucionit, i kalojnë Drejtorisë së Politikave të Turizmit meqenëse kompetencat e saj lidhen më shumë me problematikën e tyre.
3. Drejtoria e Politikave të Turizmit (DPT), brenda dy javëve nga dita e marrjes së kërkesës apo dosje-kërkesës, përfundon shqyrtimin e saj në lidhje me dokumentacionin e paraqitur teknik dhe financiaro-ekonomik.
4. Puna për ecurinë e procedurës udhëhiqet nga Drejtoria e Politikave të Turizmit.
5. Nëse kërkesa nuk është plotë, ajo i kthehet përsëri aplikantit, nga DT, me një shkresë përcjellëse, në të cilën njoftohet për plotësimet e nevojshme.
6. Nëse kërkesa është e plotë, ajo kalon për shqyrtim në Këshillin e Zhvillimit të Turizmit (KZHT).
7. Pas shqyrtimit në KZHT, dosja dorëzohet së bashku me vendimin përkatës në protokoll për arshivim dhe një bllok të dhënash për të përpunohen nga Drejtoria e Turizmit.

ANEKSI B

Dokumentacioni që duhet të paraqitet:

a) Kur është shoqëri:

- formulari i plotësuar në të gjitha seksionet përbërëse (i shtypur);
- të dhëna mbi shoqërinë (tipi, adresa, eksperiencia);
- vendimi i regjistrimit në gjykatë, statuti, akti i themelimit;
- referencat bankare;
- të dhëna financiare nëpërmjet bilancit të shoqërisë;
- analizë prefizibiliteti, (e cila presupozon analizën ekonomike, financiare, ambientale, sociale, në mënyrë të përgjithshme, me qëllimin e paraqitjes së një treguesi mbi mundshmërinë e realizimit) të projektit të propozuar;
- relacioni përshkrues i projektit;
- studimi urbanistik për zonën në interes.
- vërtetimi i titullit të pronësisë, për tokën-truall, mbi të cilën do të zhvillohet investimi, marrë nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- projekti i propozuar në nivelin e projektidesë;
- nevojat për infrastrukturë dhe paraqitja grafike e elementeve përbërëse të saj;
- dëftesa e derdhjes së shumës së garancisë;
- derdhja e shpenzimit administrativ.

b) Kur është person fizik:

- formulari i plotësuar në të gjitha seksionet përbërëse (shtypur); të dhëna mbi personin fizik (adresa, eksperiencia);
- vendimi i regjistrimit në gjykatë;
- referencat bankare;
- analizë prefizibiliteti (e cila presupozon analizën ekonomike, financiare, ambientale, sociale, në mënyrë të përgjithshme, me qëllimin e paraqitjes së një treguesi mbi mundshmërinë e realizimit) të projektit të propozuar;
- relacioni përshkrues i projektit;
- studimi urbanistik për zonën në interes (vihet në dispozicion nga sekretaria);
- vërtetimi i titullit të pronësisë për tokën-truall, mbi të cilën do të zhvillohet investimi, marrë nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
- projekti i propozuar në nivelin e projektidesë;
- nevojat për infrastrukturë dhe paraqitja grafike e elementeve përbërëse të saj;
- dëftesa e derdhjes së shumës së garancisë;
- derdhja e shpenzimit administrativ.

c) Veprimtari joturistike në zonë të stimuluar;

- kërkesa me të dhëna për aplikantin (person fizik apo juridik) dhe mbi tipin e veprimtarisë që do të zhvillohet;
- relacioni përshkrues i kritereve të projektimit;
- studimi urbanistik për zonën në interes;
- vërtetimi i titullit të pronësisë për tokën-truall, mbi të cilën do të zhvillohet investimi, marrë nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- projekti i propozuar në nivelin e projektidesë;
- derdhja e shpenzimit administrativ.

ANEKSI C

Dokumentacioni që duhet për lidhjen e marrëveshjes:

1. Studimin e fizibilitetit të tregut për projektin.
2. Programin e investimeve:
 - buxhetin e detajuar të ndërtimit dhe të zhvillimit të projektit;

- parashikimet financiare 6-vjeçare;
- paketën e sigurimit të investimit;
- 3. Planin e financimit:
 - strukturën e fondeve;
 - paraqitjen e investitorëve, përfshirë veprimtarinë financiare dhe përvojën e tyre;
 - burimet dhe afatet e kredisë kryesore;
 - burimet dhe afatet e kredive dytësore dhe të tjerave;
 - shpenzimet e periudhës së parandërtimit;
 - nivelin dhe tipin e financimit të kërkuar;
 - kalendarin e rimbursimit (shlyerjes së kredisë);
- 4. Aspektet e zhvillimit:
 - përfitimet e ekonomisë vendore;
 - parashikimi i përdorimit të produkteve dhe të shërbimeve vendore.
- 5. Leja e ndërtimit, shoqëruar me projektin e miratuar nga organet përkatëse.

Formulari 1

**KËRKESË PËR KRYERJEN E NJË VEPRIMTARIE NË NJË ZONË
PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT**

**PËRMBLEDHJE (Mos e plotëso këtë pjesë të formularit)
KANDIDATI**

VEPRIMTARIA

LOKALIZIMI

INVESTIMI SIÇ PARASHIKOHET NGA KANDIDATI

DATA E MARRJES SË FORMULARIT NGA KANDIDATI

KODI I IDENTIFIKIMIT TË PROJEKTIT

PERSONI I KONTAKTUAR

SEKSIONI 1

1. KANDIDATI

1.1 NË QOFTË SE ËSHTË INDIVID:

1.1.1 EMRI I PLOTË

1.1.2 KOMBËSIA

1.1.3 ADRESA E BANIMIT

1.1.4 ADRESA E PUNËS

1.1.5 REKOMANDIMET BANKARE

1.1.6 EKSPERIENCA E MËPARSHME NË INDUSTRIJËN E TURIZMIT

1.2 NË QOFTË SE ËSHTË KORPORATË:

1.2.1 EMRI I PLOTË I KORPORATËS

1.2.2 TIPI

1.2.3 ADRESA

1.2.4 VENDI I INKORPORIMIT, REGJISTRIMIT DHE TË DHËNAT PËRKATËSE

1.2.5 PRONËSIA DHE KONTROLLI

1.2.6 KAPITALI

1.2.7 REKOMANDIMET BANKARE

1.2.8 TË DHËNAT EKONOMIKE DHE FINANCIARE (FITIMI DHE HUMBJA, FLETA E BILANCIT); JEPNI DOKUMENTET PËRKATËSE (në qoftë se ken)

1.2.9 VEPRIMTARITË KRYESORE TË KANDIDATIT; EKSPERIENCAT E MËPARSHME NË INDUSTRIJËNË E TURIZMIT

SEKSIONI 2. VEPRIMTARIA

2.1 TIPI I VEPRIMTARISË (bëhet fjalë për një ose më shumë nga kategoritë e listuara në aneksin A të këtij formulari)

2.2 NEVOJAT PËR VEPRIMTARI (bëni një studim paraprak fesibiliteti; jepni dokumentet, në qoftë se është e përshtatshme)

2.3 ZBATIMI

2.3.1 PROJEKTI (përshkruani në detaje projektin; bashkëlidhur dokumentet përkatëse)

2.3.2 OPERIM (Përshkruani sesi veprimtaria e stimuluar do të prodhojë të ardhura dhe cila njësi do të ngarkohet me këtë detyrë; n.q.s. njësia nuk është kandidat, të sigurohet, përsa i përket operatorit, informacioni i kërkuar në pikat 1.1 b dhe 1.2 më sipër.)

SEKSIONI 3. LOKALIZIMI

3.1 IDENTIFIKIMI I SHESHIT (bashkëlidh kartën)

RRETHI _____
BASHKIA _____
KOMUNA _____
FSHATI _____

3.2 SIPËRFAQJA E KËRKUAR (specifikoni sipërfaqen totale të nevojshme për projektin dhe bëni të ditur arsyen pse nevojitet ajo)

3.3 INFRASTRUKTURAT (specifikoni infrastrukturën dhe shërbimet komunale të kërkuara nga projekti. Bëni të ditur, gjithashtu, sesi projekti do të zgjidhë çështje të tilla që mund të bëjnë që infrastruktura dhe shërbimet të jenë të pamjaftueshme.)

3.4 AMBIENTI

3.4.1 SHFRYTËZIMI I TANISHËM I SHTETIT

3.4.2 NDIKIMI I MUNDSHËM I PROJEKTIT MBI AMBIENTIN

3.5 KRITERET E PROJEKTIMIT DHE TË NDËRTIMIT (jepni dokumentet përkatëse siç janë planet e sheshit dhe vizatimet fillestare arkitektonike)

SEKSIONI 4. INVESTIMI

4.1 KOSTOJA E PROJEKTIT

Shpenzimet paraprake _____

- Shërbimet teknike dhe urbanistike _____
- Kostoja e zhvillimit _____
- Parashfrytëzimi _____
- Kapitali qarkullues _____

Ndërtimi dhe pajisja

- Ndërtimi _____
- Mobilimi dhe pajisja _____

Infrastruktura

Shërbimet komunale

Shërbimi i qiradhënies _____

Të tjera (gjëra të paparashikuara)

BUXHETI TOTAL

4.2 STRUKTURA E FINANCIMIT

Ekuiteti _____

Kandidati _____

Të tjerët _____

Totali _____

Hua

FINACIMI TOTAL

4.3 KOHA E REALIZIMIT TË PROJEKTIT

4.4 PROJEKTI FINANCIAR

4.4.1 PERIUDHA E ZHVILLIMIT

Viti-Burimet e mjeteve financiare-Ekuiteti-Borxhi-Burimet totale-Përdorimi i mjeteve financiare-Shërbimet teknike dhe urbanistike-Kostoja e zhvillimit-Parashfrytëzimi-Kapitali qarkullues-Ndërtimi-Mobilimi dhe pajisja-Infrastruktura-Shërbimet komunale-Shërbimi i qiradhënies-Kostoja e financimit- Shpenzime totale

4.4.2 SHFRYTËZIMI (vënia në punë)

Viti

Burimet e të ardhurave

Të ardhura totale Kostoja e shitjes

Kostoja totale e shitjes. Shpenzime të pashpërndara

Shpenzime totale të pashpërndara

Kostoja dhe shpenzime totale

Të ardhurat para ngarkesave të fiksuara

4.5 NDIKIMI I ZHVILLIMIT

4.5.1 PËRFITIMI I EKONOMISË VENDASE DHE PUNËSIMI (duke përfshirë edhe programin e përgatitjes)

4.5.2 PËRDORIMI DHE SHFRYTËZIMI I PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE TË VENDIT

DATA DHE FIRMA

(Jepni dëshmi që ju jeni autorizuar nga kandidati të nënshkruani këtë formular.

VENDIM
Nr. 804, datë 16.12.2005

**PËR PËRZGJEDHJEN E SHOQËRISË PËR KONTROLLIN E PROCEDURAVE DHE
LIGJSHMËRINË E KONTRATËS PËR PRIVATIZIMIN E ALBTELECOM SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontrolli i procedurave dhe i ligjshmërisë së kontratës për privatizimin e Albtelecom sh.a. të bëhet nga një shoqëri e përzgjedhur me tender të hapur, në bazë të termave të referencës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TERMAT E REFERENCËS
**RISHIKIMI I PROCEDURAVE DHE LIGJSHMËRIA E KONTRATËS PËR PRIVATIZIMIN E
ALBTELECOM SHA**

A. Përmbledhje

Procesi i privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom”, u realizua në kuadrin e privatizimit të sektorëve strategjikë, në përputhje me strategjinë e privatizimit, të miratuar me ligjin nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”.

Në kuadrin e përgatitjes për privatizim, në bashkëpunim me konsulentin ndërkombëtar të privatizimit, u përgatit dhe u miratua ligji nr.8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom”, si edhe disa akte nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Sipas procedurave, u realizua faza e marketingut për të përgatitur fillimin e procedurave të tenderit dhe për të vijuar më tej me përzgjedhjen e investitorit strategjik.

Për këtë qëllim, në muajt shtator, tetor dhe nëntor 2004, u publikua ftesa për shprehjen e interesit për blerjen e aksioneve të Albtelecom, në gazetën ndërkombëtare, “Financial Times”, “Wall Street Journal Europe” dhe “The Economist”, si edhe në disa gazeta të vendit.

Pas përfundimit të afatit për paraqitjen e shprehjes së interesit, rezultuan 11 kompani të interesuara për blerjen e aksioneve të shoqërisë “Albtelecom”.

Duke ballafaquar dokumentacionin e paraqitur nga kompanitë e interesuara me kërkesat e publikuara në ftesën për shprehjen e interesit dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.653, datë 21.11.2001 “Për kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë të interesuar për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime “Albtelecom” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.417, datë 2.7.2004 “Për kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e shoqërisë anonime “Albtelecom”), rezultoi se me gjithë dhënien e mundësisë për të paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, disa kompani nuk u klasifikuan për të marrë pjesë në fazat e mëtejshme të procesit.

Nga vlerësimi i shprehjeve të interesit të paraqitura, u klasifikuan 4 kompani që plotësonin kushtet për të vazhduar më tej garën.

Kompanive të përzgjedhura iu dërgua një marrëveshje konfidencialiteti dhe pas kthimit të nënshkruar, palët e interesuara u pajisën me memorandum informativ dhe me dokumente të tjera të nevojshme për kompaninë dhe procesin. Të katra kompanitë, për një periudhë prej afro njëmuajore, realizuan procesin e “due diligences”, me grupe të specializuara ekspertësh në përputhje me programet e miratuara më parë. Të dhënat e ofruara, tashmë publike, janë të audituara nga ekspertë kontabël (vendas) dhe ekspertë auditues ndërkombëtarë (Deloitte&Touche).

Në përputhje me instruksionet e tenderit (miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.151, datë 18.3.2005 “Për miratimin e instruksioneve për paraqitjen dhe hapjen e ofertave për privatizimin e shoqërisë anonime “Albtelecom””), data 6 maj 2005 shënoi mbylljen e fazës së tenderit nëpërmjet paraqitjes së ofertave për blerjen e aksioneve të shoqërisë Albtelecom.

Në procesin e paraqitjes së ofertave, u prezantua vetëm një ofertë nga Calik Enerji Telekomunikasyon-Turqi, oferta financiare e së cilës arrinte në vlerën 120 milionë euro.

Në vijim të procedurave, komisioni i vlerësimit të ofertave shqyrtoi ofertën e paraqitur në përputhje me instruksionet e tenderit dhe me kriteret e vlerësimit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Raporti i vlerësimit të ofertave u përgatit nga konsulentët e privatizimit të kompanisë IMI dhe pas shqyrtimit dhe miratimit nga komisioni i vlerësimit të ofertave u miratua nga Këshilli i Ministrave (vendimi i Këshillit të Ministrave nr.359, datë 26.5.2005 “Për miratimin e raportit të vlerësimit të ofertave dhe të fituesit në tenderin e hapur ndërkombëtar për privatizimin e shoqërisë anonime “Albtelecom””).

Më datë 9 qershor 2005 filluan negociime me kompaninë fituese të tenderit “Calik Enerji Telekomunikasyon A.S.” dhe më datë 23 qershor 2005 u nënshkrua kontrata për shitjen e aksioneve me këtë kompani. Kontrata parashikon ratifikimin e kontratës nga Kuvendi, për të cilin u bë paraprakisht miratimi nga Këshilli i Ministrave i vendimit për propozimin e projektligjit përkatës (vendimi i Këshillit të Ministrave nr.515, datë 8.7.2005 “Për propozimin e projektligjit “Për ratifikimin e kontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime “Albtelecom””).

B. Qëllimi i ekspertizës

Vendimi i Kuvendit nr.7, datë 13.10.2005 “Për mosmiratimin e projektligjit “Për ratifikimin e kontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime “Albtelecom” dhe ekspertizën ndërkombëtare në lidhje me të” ngarkon Këshillin e Ministrave të rishikojë nëpërmjet një ekspertize të huaj procedurat e privatizimit të Albtelecom-it dhe kontratën e arritur.

Qëllimi i kësaj ekspertize do të jetë analiza dhe vlerësimi i procedurave të privatizimit, që nga publikimi për shprehjen e interesit deri te realizimi i kontratës me firmën e përzgjedhur.

Kjo ekspertizë do të shqyrtojë me imtësi ligjshmërinë e procedurave të ndjekura për privatizimin e Albtelecom sh.a., si dhe formulimin e kontratës.

C. Detyrat specifike

Bazuar në informacionin ekzistues dhe në atë shtesë që mund të kërkohej, ekspertiza do të synojë në disa drejtime:

- Procedurat e ndjekura për publikun e ftesës për shprehjen e interesit;
- Procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e investitorëve strategjikë;
- Procedurat e ndjekura për vlerësimin e ofertave të paraqitura për privatizimin e Albtelecom sh.a., si dhe seleksionimi i shortlistës;
- Ligjshmëria e formulimeve të kontratës;
- Mbrojtja e interesave të palëve, shqyrtimi nëse realizohet paanshmëria e përfitimeve nga të dyja palët;
- Vlerësimi i disa elementeve të sigurisë kombëtare (si p.sh. electronic hacking/terrorism, governmental and/or corporate espionage).

Ekspertët do të marrin në shqyrtim të gjitha procedurat e ndjekura që kanë të bëjnë me publikimet (brenda dhe jashtë vendit) të ftesës për shprehjen e interesit. Ato gjithashtu do të japin vlerësime për kriteret dhe procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e investitorëve strategjikë. Ky vlerësim mund të jetë në drejtim të bazës ligjore referuese për vlerësim, zbatimin të kriterëve të përcaktuara për përzgjedhje etj.

Në lidhje me procesin e vlerësimit të ofertave, mund të verifikohet nëse procesi në tërësi i përmbush kushtet për një tender të hapur dhe konkurrues. Përveç kësaj në drejtim të zbatimit të procesit dhe rezultatit të tenderit, duhet të vlerësohet edhe fakti nëse marrëveshja e konfidencialitetit e lidhur me kompanitë pjesëmarrëse, garantonte vlerësimin e ofertave dhe pranimin si të suksesshëm të tenderit, edhe në rastin e paraqitjes së një oferte të vetme.

Në drejtim të ligjshmërisë së formulimeve të kontratës së shitjes, ekspertët duhet të verifikojnë nëse klauzolat e saj janë të bazuara në legjislacionin në fuqi, nëse janë mbrojtur dhe optimizuar interesat e palës shitëse. Ata gjithashtu duhet të vlerësojnë nëse formulimet e kushteve të kontratës janë në përputhje dhe në zbatim të politikave sektoriale për liberalizimin e tregut të telekomunikacioneve dhe nëse plotësojnë detyrimet e marrëveshjes me OBT-në.

D. Propozimi teknik

Propozimi teknik duhet të përfshijë:

1. Pasqyrë të dhënash të përgjithshme për firmën dhe eksperiencën e saj në detyra të këtij lloji;
2. Një përshkrim të detajuar të strategjisë që do të propozojë firma për të marrë përsipër këtë detyrë;
3. Një listë dhe informacion në lidhje me personelin kryesor që do të caktohet për këtë detyrë.

Në përgatitjen e propozimit dhe përzgjedhjen e personelit që propozon firma për realizimin e kësaj detyre, duhet t'i kushtohet kujdes disa kritereve, sipas të cilave do të vlerësohet edhe propozimi.

Konsulentët investigues të kualifikuar duhet të jenë me nivel të lartë ekspertize në kontrollin e procedurave dhe një eksperiencë të suksesshme në fushat e mëposhtme:

- Ekspertizë në investigimin e praktikave të korruptuara si qeveritare, ashtu edhe joqeveritare, duke vënë theksin veçanërisht në fushën e privatizimit;
 - Ekspertizë në auditimin dhe kontrollin e procedurave për një investigim të gjithanshëm;
 - Kredenciale qeveritare të niveleve të larta në lidhje me investigimin dhe kontrollin procedural;
 - Eksperiencë ligjore dhe ekspertizë në shqyrtimin e transaksioneve të mëdha financiare ndërkombëtare dhe komplekse;
 - Ekspertizë për një vlerësim shumë të hollësishëm të rrjetit dhe sigurisë kombëtare që rezulton nga shitja e Altelecom-it palës së tretë.
- Propozimi duhet të tregojë kohën për realizimin e ekspertizës.

UDHËZIM

Nr. 1, datë 30.11.2005

PËR TARIFAT E SHËRBIMIT PËR LEJET MJEDISORE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr. 8990, datë 23.01.2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis",

UDHËZUJ:

1. Angazhimet e agjencive rajonale të mjedisit dhe të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për shqyrtimin e kërkesës dhe marrjen e vendimit për lejet mjedisore, vlerësohen si shërbime ndaj të tretëve dhe paguhen nga kërkesuesi në formën e tarifave të shërbimeve.
2. Vlera e tarifës përfshin shpenzimet administrative, si dhe gjithë veprimtaritë konkrete të agjencive rajonale të mjedisit dhe të Ministrisë gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës për miratimin e projektit dhe të dokumentacionit shoqërues dhe marrjes së vendimit përkatës.

3. Tarifa e paguar është e pakthyeshme, pavarësisht nga fakti nëse kërkesa miratohet ose jo përfundimisht nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

4. Tarifa duhet të jetë e paguar në momentin e dorëzimit të dokumentacionit e të regjistrimit të tij në protokoll.

5. Tarifa e shërbimit paguhet edhe për veprimtaritë me karakter vendor që ndikojnë në mjedis dhe që miratohen nga agjencitë rajonale të mjedisit në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore dhe që pajisjen me autorizim mjedisor ose pëlqim mjedisor.

6. Tarifa derdhet nga propozuesi në bankë, në adresën: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Raiffeisen Bank, nr.llogarie 317/4302, përshkrimi; Tarifë për deklaratë mjedisore, leje mjedisore, autorizim mjedisor ose pëlqim mjedisor (sipas rastit).

7. Shpenzimet e përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të diskutimit publik, të shqyrtimit dhe këshillimit, përballohen nga propozuesi. Këto shpenzime nuk janë pjesë e tarifës së shërbimit.

8. Përcaktimi i tarifës së shërbimit bëhet mbi bazën e kohës dhe mjeteve të shpenzuara gjatë procesit të shqyrtimit dhe marrjes së vendimit. Këtu përfshihen: shqyrtimi fillestar i dokumentacionit, klasifikimi i kërkesës për të vendosur nëse projekti do t'i nënshtrohet procesit të thelluar apo të përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis, asistenca për subjektet që aplikojnë, komunikimet me organet që japin lejet e ndërtimit dhe të veprimtarisë, organet e qeverisjes vendore, inspektimin e vendit, këshillimin me organet e qeverisjes vendore, të zhvillimit urban dhe turistik, dhënien e mendimit dhe kushtet që duhen vendosur, përcjellja në Ministri, shqyrtimi në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, këshillimi me palët e interesuara, debati publik, shqyrtimi në komisionin e shqyrtimit të kërkesave dhe marrja e vendimit;

9. Klasifikimi i tarifave bëhet sipas këtyre kriterëve:

- a) madhësia e projektit, shkalla e shtrirjes së tij;
- b) përdorimi i burimeve natyrore;
- c) vendndodhja e zbatimit të projektit ose e ushtrimit të veprimtarisë;
- d) shkalla e ndotjes së mjedisit;
- e) llojet e ndikimeve negative;

10. Projektet dhe veprimtaritë e shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe strategjitë e planet e veprimit për energjetikën, minierat, industrinë, transportin, bujqësinë, pyjet, për administrimin e burimeve natyrore dhe të pasurive minerale dhe për administrimin e mbeturinave, planet kombëtare dhe rajonale të rregullimit të territorit për qendrat e zonat urbane dhe rurale, për zonat industriale, për zonat bregdetare, për zonat turistike, për zonat e mbrojtura dhe zonat me ndjeshmëri të lartë ndaj ndotjes dhe dëmtimit, kanë tarifa më të larta. Projektet dhe veprimtaritë e shtojcës 2 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” kanë tarifa relativisht më të ulëta. Projektet dhe veprimtaritë me karakter vendor që ndikojnë në mjedis dhe që pajisjen me autorizim mjedisor ose pëlqim mjedisor, kanë tarifa më të ulëta.

11. Projektet dhe veprimtaritë që kryhen për mbrojtjen e mjedisit ose që jepen si ndihmë për Shqipërinë, përjashtohen nga tarifa e shërbimit për dhënien e lejes mjedisore dhe leja mjedisore u akordohet falas.

12. Mbështetur në kriteret e mësipërme, për dhënien e deklaratës mjedisore, tarifa e shërbimit është 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.

13. Për dhënien e lejeve mjedisore, do të aplikohen këto tarifa shërbimi:

a) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive në industrinë energjetike, si: rafineritë e naftës dhe të gazit; lëngëzimi dhe përpunimi i qymyrit dhe rërave bituminoze, impiante për rigjenerimin e vajrave të përdorur; hidrocentrale; termocentrale; depozita të mëdha për magazinimin për qëllime tregtimi apo ruajtje për naftën, nënproduktet e saj dhe produktet kimike; impiante industriale për prodhimin e energjisë, avullit dhe ujit të nxehtë; uzina për gazifikimin dhe lëngëzimin e qymyrit dhe të rërave bituminoze etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përkasin shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 40 000 (dyzet mijë) lekë.

b) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të prodhimit dhe përpunimit të metaleve, si: uzina të shkrirjes së mineraleve; kalçinimi dhe pjekja e mineraleve që përmbajnë elemente toksike; uzinat për prodhimin e gizës dhe çelikut; uzinat ose fonderitë për përpunimin e hekurit; fonderitë; uzina për trajtimet sipërfaqësore të metaleve dhe materialeve plastike; prodhimi i hekurit të kuq dhe çelikut me derdhje të vazhdueshme; shfrytëzimi i minierave të mineraleve metalore; fabrikat e pasurimit të mineraleve etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përkasin shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 40 000 (dyzet mijë) lekë.

c) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të nxjerrjes dhe përpunimit të materialeve bazë që nuk kanë në përbërje minerale xeherore, si: prodhimi dhe përpunimi i aliazheve për metale jo ferrike; nxjerrja dhe përpunimi i qymyrit, linjtit dhe mineraleve bitumene; nxjerrja e naftës e gazit natyror; fabrika për prodhimin e çimentos, gëlqeres; qelqit, përfshirë fibrat e xhamit; fonderitë për shkrirjen e substancave minerale, përfshirë prodhimin e fibrave minerale; fabrika për prodhimin e qeramikës; guroret dhe minierat e hapura të argjilave ose nxjerrja e torfes; nxjerrja e mineral-inerteve nga drenazhimi detar dhe lumor; shpimet e thella; nxjerrja e qymyrit, naftës, gazit natyror dhe rërës bituminoze; shkrirja fillestare dhe prodhimi i gizës dhe çelikut, etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përkasin shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 40 000 (dyzet mijë) lekë.

d) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive në industrinë kimike, si: prodhimi i kimikateve organike dhe inorganike bazë; prodhimi i plehrave me bazë fosfatike ose fosfatike azotike; prodhimi i produkteve me bazë bimore; impiantet që përdorin proceset kimike ose biologjike për prodhimin e produkteve me bazë farmaceutike, bojërave dhe pesticideve; impiantet kimike që prodhojnë lëndët shpërthyes; shtesa ushqimore proteinike, fermente; trajtimi i produkteve të ndërmjetme dhe prodhimi i kimikateve etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përkasin shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 40 000 (dyzet mijë) lekë.

e) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive të industrisë ushqimore, si: prodhimi i vajrave dhe yndyrave shtazore dhe bimore; paketimi dhe ambalazhimi i produkteve bimore; prodhimi i produkteve bulmetore; prodhimi i birrës; prodhimi i shurupeve dhe ëmbëlsirave; fabrikat e peshkut dhe vajit të peshkut; fabrikat e sheqerit; prodhimi i pijeve joalkoolike, prodhimi i produkteve ushqimore etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përkasin shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 40 000 (dyzet mijë) lekë.

f) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive të industrisë tekstile, të lëkurëve, të drurit dhe letrës, si: prodhimi i fibrave të kartonit nga druri ose materiale me fibra të ngjashme; impiante industriale për prodhimin e pulpës nga lëndët drusore ose fibrave të tjera të ngjashme, letrës dhe kartonave; paratrajtimin ose lyerjen e fibrave dhe tekstileve; trajtimin e lëkurëve dhe thundrave; përpunimin dhe prodhimin e celulozës; prodhimin e mobiljeve etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përkasin shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 40 000 (dyzet mijë) lekë.

g) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive të industrisë së gomës, si: prodhimi dhe përpunimi i produkteve me bazë rezinash natyrore dhe sintetike, kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përkasin shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 40 000 (dyzet mijë) lekë.

h) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive të administrimit të mbetjeve, si: impiante për përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme apo të mbeturinave urbane; impiante për përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve të degëve të ndryshme të industrisë; vendgroposjet (landfillet) vendet e depozitimit të mbetjeve industriale, vendet e depozitimit të inerteve etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përkasin shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 40 000 (dyzet mijë) lekë.

i) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive të tjera (impiante të ndryshme) për: testimin e motorëve, turbinave, reaktorëve, shkatërrimin e lëndëve eksplozive, për therjen e kafshëve, për prodhimin e fibrave minerale artificiale; për rritjen intensive të shpendëve, derrave e bagëtive të imta; rrugë për testimin dhe garat e mjeteve të motorizuara; projekte të fushës së mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, depo etj.; bujqësi, silvikulturë dhe akuakulturë: projekte për restaurimin e zonave rurale; pyllëzimi dhe shpyllëzimi; menaxhimi i ujërave për nevoja bujqësore; fermat e peshkimit; marrja e tokës nga deti; rregullimet e lumenjve etj. projekte të infrastrukturës: projekte të zhvillimit industrial, urban; të qendrave të blerjes dhe parkimet e automjeteve; ndërtimi i linjave hekurudhore; aeroporteve; rrugëve; porteve; rrugëve ujore në brendësi të tokës; tramvajeve; kanalizimeve të ujërave të zeza; impianteve të trajtimit të ujërave të zeza; dampave dhe rezervuarëve; ndërtimi i ujësjellësve; puna në bregdet kundër erozionit; nxjerrja e ujërave nëntokësore dhe skemat e rimbushjes artificiale të ujrave nëntokësore; projekte për transferimin e burimeve ujore midis baseneve të lumenjeve; akuadukte etj.; turizmi dhe koha e lirë: teleferikët e skive; portet turistike; fshatra turistike dhe komplekset e hoteleve jashtë zonave urbane dhe të zhvillimeve të shoqëruara me këto lloj veprimtarish; zona të karavaneve dhe kampeve; parqet zbavitëse; punimet me rrezatimet elektromagnetike jojonizuese, si dhe sistemet e transmetimit është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

14. Në dhënien e autorizimeve mjedisore do të aplikohen këto tarifa shërbimi:

a) Tarifa e shërbimit për pika karburanti me pakicë, sharrim i lëndës drusore e i trupave, përpunim druri, mobileri, distributor për mbushje gazi, magazinim vajrash lubrifikant, rrugë, ujësjellës, kanalizime, magazina etj. është 20 000 (njëzet mijë) lekë;

b) Tarifa e shërbimit për prodhim produktesh ushqimore: punishte ëmbëlsirash, furra buke etj. është 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

15. Në dhënien e pëlqimeve mjedisore do të aplikohen këto tarifa shërbimi:

a) Tarifa e shërbimit për apartamente dhe objekte social-kulturore është 2000 (dy mijë) lekë;

b) Tarifa e shërbimit për objekte banimi njëfamiljare, objekte të vogla shërbimesh etj. është 1000 (një mijë) lekë;

16. Tarifa e shërbimit për përtëritje të lejeve dhe autorizimeve mjedisore do të jetë sa gjysma e tarifës për marrjen e lejes sipas këtij këtij udhëzimi.

17. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr.1, datë 8.02.2000 “Për përcaktimin e tarifave të lejeve të mjedisit” shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

Fletorja Zyrtare gjendet:

- duke u abonuar pranë njërive postare të qyteteve ose
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën:
Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; 267 468
www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR
NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005**

1. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE	1500
2. INDEKSI ALFABETIK	1200
3. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA	1000
4. REGJISTRI I TESTAMENTEVE	1000

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë, Vëllim i II-të, Botim 2005).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim i II-të)	1500
2. KODI DOGANOR	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 29.12.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë